REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / ZYRA ZA KONTROLLIMIT NDËRKOHËSOR
Nr/Br. 411/20
Data/Datum. 24.06.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Kompania e Ujësjellësit Rajonal Prishtina sh.a*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **70433736-19-9585-1-2-1/KURP-19-032-1-2-1**

Sa i përket tenderit për *Furnizim me Hardver për TI (Furnizimi PC All in One dhe me PC-workstation për Gis) dhe Paisje Mobile për Printim të Faturave*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Botek shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Agim Ramadani, objekti C, nr 51
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

038-245-830/840 — *038-245-625*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Hilmi Asllani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@bo-tek.com
(Adresa elektronike)

23.06.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Communication · Energy
BOTEK sh.p.k.
Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Letër Standarde e Kërkesës për Sqarimin e Tenderit, datë 07.05.2020;*
- *Përgjigjet në Sqarimin e Tenderit, nga Botek shpk, datë 08.05.2020.*
- *Raporti i ri vlerësimit të tenderëvve sipas vendimit të OSHP nr 123/20, datë 18.05.2020;*
- *Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, 19.05.2020;*
- *Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës, 19.05.2020;*
- *Kërkesa për Rishqyrtim nga OE "TMS Mobile" shpk, 26.05.2020;*
- *Raporti i ri vlerësimit të tenderëve pas Kërkesës për Rishqyrtim, datë 10.06.2020;*
- *Vendimi nga Autoriteti Kontraktues, për anulimin e procedurës së prokurimit, datë 10.06.2020.*
- *Kërkesa për Rishqyrtim nga OE "Botek " shpk, datë 15.06.2020;*
- *Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në Kërkesën për Rishqyrtim, datë 16.06.2020.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] Jo [ ]

Hapja e tenderit është bërë në formë elektronike. Procesverbali është publikuar në platformën e E-Prokurimit, me datë: 13.01.2020

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

- *Kërkesa për Rishqyrtim nga OE "Botek " shpk, datë 15.06.2020;*
- *Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në Kërkesën për Rishqyrtim, datë 16.06.2020.*

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 i LPP, paragrafi 2 dhe 4
Pika 39.7 i RRUOPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5.000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përshkrimi kronologjik i procesit pas Vendimit të OSHP për Rivlerësim:

Pas Vendimit të OSHP (dt. 02.04.2020) që lënda të kthehet në Rivlerësim AK gjegjësisht Komisioni i Vlerësimit të Tenderëve, kishte kërkuar zgjatjen e validitetit të Ofertave nga të gjithë OE pjesëmarrës në tender.

Nga shkresat e Lëndës del se vetëm 2 OE (Botek shpk dhe TMS Mobile) nga 7 OE sa kanë marre pjesë në tender, kanë bërë Vazhdimin e Validitetit të ofertave të tyre duke bërë edhe zgjatjen e validitetit të sigurimit të tenderit.

Nga shkresat e lëndës gjithashtu mund të konstatohet se me datë **04.05.2020** AK (KUR

Prishtina) gjatë procedurës së Rivlerësimit ka dërguar Letra Standarde për Sqarimin e Tenderit për ne OE BOTEK shpk, si dhe OE TMS Mobile *(Prova 1_ Dok. **"Letër standarde e Kërkesës për Sqarimin e Tenderit"** nga AK).*

Sipas LPP Neni 59. Pika 2 & 4 si dhe Rregullores së UOPP Pika 39.6 *"AK do të caktoj afat kohorë të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre"*, AK duke zbatuar pikërisht këtë rregullore kishte caktuar afatin formal për kthimin e përgjigjeve nga OE, datën; 07.05.2020 ora 10.00 .

Brenda këtij afati të përcaktuar nga ana e AK ne (Botek shpk) kemi kthyer përgjigjet tona duke dhënë faktet e mjaftueshme të cilat ri-konfirmojnë se oferta jonë teknike përmbushë 100% të gjitha kërkesat nga dosja e tenderit.*(Prova 2_Dok **Përgjigjet në Kërkesën për Sqarime Shtesë**).*

- Tutje, nga shkresat e Lëndës, (*Prova 3_ Dok **"Raportin e Vlerësimit të Komisionit"*** dt. 18.05.2020) Komisioni i Ri-vlerësimit konstaton se OE TMS Mobile shpk të shpallet i eliminuar për arsye se NUK ka kthyer përgjigje në Letrën Standarde të Kërkesës për Sqarimin e Tenderit.
- Gjithashtu edhe Vendimi i AK (shih dokumentin e eliminimit të OE TMS Mobile dt. 19.05.2020, (*Prova 4_Dok **"Letër Standarde për tenderuesin e eliminuarë"***) dhe mund të konstatohet qartësisht se OE TMS Mobile NUK ka kthyer fare përgjigje në kërkesën e AK për sqarimin e tenderit, brenda afatit të përcaktuar nga AK ashtu sikurse parashihet me LPP dhe RRUOPP, rrjedhimisht, kishte marrë Vendim për eliminimin e OE TMS Mobile shpk si të papërgjegjshëm.

Pra, "Kërkesa për Rishqyrtim" e datës 26.05.2020, e parashtruar nga OE TMS Mobile është në kundërshtim me LPP Neni 59 si dhe RRUOPP Pikat 39.6, ku qartësisht precizohet procedurat për Sqarimin e Tenderit, dhe 39.7 ku thuhet se "*Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK tenderi përkatës do të refuzohet*".

Prandaj, duke pas parasysh faktin se OE TMS Mobile shpk, NUK ka qenë i lejuar të shtroj fare Kërkesë për Rishqyrtim pasi që i njëjti është vetë-eliminuar duke mos kthyer përgjigje në kërkesën e AK për sqarime të tenderit, Kërkesa për Rishqyrtim rrjedhimit është jo valide, apo do te duhej të refuzohej pa shqyrtim në bazë të RRUOPP pika 39.7.

Rrjedhimisht, AK ka bërë shkelje të LPP dhe RRUOPP duke marrë në shqyrtim një kërkesë të tillë e cila "kërkesë për rishqyrtim" po ashtu nuk është marrë fare me arsyet dhe faktet eliminimit të vetë OE TMS Mobile për të qenë vetë si OE i përgjegjshëm.

Për me tepër ky komision i ka bërë një lloj "Rivlerësimin përfundimtar" duke anuluar jashtëligjshëm edhe tenderin në tërësi duke shkel të gjitha principet e LPP dhe Procedurave Ligjore si dhe RRUOPP.

Andaj duke konstatua këto shkelje (përtej çdo dyshimi) nga ana e AK dhe këtij "Komisioni të Vlerësimit apo Rivlerësimit", i cili i ka shkel qartësisht procedurat dhe LPP dhe RRUOPP (neni 39.7), kërkojmë që ky lloj "Vendimi për ANULIM" si i pabazuar dhe jashtëligjshëm të tërhiqet dhe lënda të kthehet në procedurë duke vazhduar me nënshkrimin e Kontratës pasi që janë përmbushur të gjitha procedurat e Prokurimit ne lidhje me këtë lëndë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Fitimi i humbur nga mosrealizimi i kësaj kontrate (min 10%). **Shpenzimet financiare për përgaditjen e dosjes së tenderit dhe parashtrimin e ankesës.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë.

a) *Letër Standarde e Kërkesës për Sqarimin e Tenderit, datë 07.05.2020_**Prova 1**.*
b) *Përgjigjet në Sqarimin e Tenderit, nga Botek shpk, datë 08.05.2020_**Prova 2**.*
c) *Raporti i ri vlerësimit të tenderëvve sipas vendimit të OSHP nr 123/20, datë 18.05.2020_**Prova 3**.*
d) *Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, 19.05.2020_**Prova 4***
e) *Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës, 19.05.2020.*
f) *Kërkesa për Rishqyrtim nga OE "TMS Mobile" shpk, 26.05.2020.*
g) *Raporti i ri vlerësimit të tenderëve pas Kërkesës për Rishqyrtim, datë 10.06.2020.*
h) *Vendimi nga Autoriteti Kontraktues, për anulimin e procedurës së prokurimit, datë 10.06.2020.*
i) *Kërkesa për Rishqyrtim nga OE "Botek " shpk, datë 15.06.2020.*
j) *Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në Kërkesën për Rishqyrtim, datë 16.06.2020.*
k) *Dëshmia e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-se.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*